

**Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e  
Legjislacionit Mjedisor**

*Një projekt për Shqipërinë financuar nga Bashkimi Evropian*

**Projektligj**  
**për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore Industriale që  
shkaktohen nga substance të rrezikshme\***

**Draft 3 version 2**

**07.06.2011**

---

\* Ky Ligj transponon plotësisht Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme, të amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**Draft 3 version 2**

**07.06.2011**

## L I G J

Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

### PËR KONTROLLIN E RREZIQEVE NGA AKSIDENTET INDUSTRIALE MADHORE QË SHKAKTOHEN NGA SUBSTANCE TË RREZIKSHME (1)

Në mbështetje të Neneve 78, 83 pika 1 dhe 174 të Kushtetutës, me propozim të  
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

### ***Kreu 1. Dispozita të Përgjithshme***

#### **Neni 1. Qëllimi**

Ky ligj synon parandalimin e aksidenteve madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme dhe kufizimin e pasojave të tyre mbi njerëzit dhe mjedisin, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtje.

#### **Neni 2. Përkufizime**

1. Termat e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:
  - a. “**Autoriteti Kompetent**” interpretohet në përputhje me Nenin 3;
  - b. “**Autoriteti Shëndetësor i zonës**” është
  - c. “**kontroll**” në lidhje me një person është kontrolli në rrjedhën e tregtisë,
  - d. **biznesit apo një sipërmarrjeje tjetër të kryer nga ai;**
  - e. “**substancë e rrezikshme**” është substanca, përzierja apo preparati,
    - i. i listuar në kolonën 1 të Pjesës 1 të Aneksit I, ose,

---

\* Ky Ligj transponon plotësisht Direktivën 96/82/EC për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme, të amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008.

- ii. që bën pjesë në një nga kategoritë e specifikuar në kolonën 1 të Pjesës 2 të Aneksit I, që është i pranishëm si lëndë e parë, produkt, nën-produkt, i mbetur apo i ndërmjetëm, përfshirë edhe ato substanca që llogjikisht mendohet se mund të gjenerohen në rast aksidenti;
- f. **“shërbime të emergjencës civile”** kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin nr. 8756, dt. 26.03.2001 “Për emergjencat civile” i ndryshuar.
- g. **“ndërmarrje”** është e gjithë zona që kontrollohet nga i njëjti operator ku substancat e rrezikshme janë të pranishme në një ose më shumë instalime, përfshirë infrastrukturën apo aktivitetet e përbashkëta apo që lidhen me to;
- h. **“ndërmarrje ekzistuese”** është ndërmarrja që ka filluar të operojë para hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe që i nënshtrohet atij menjëherë pas hyrjes së tij në fuqi;
- i. **“rrezik”** është një veti e brendshme e një substance të rrezikshme apo shtete fizike, që ka potencial për të shkaktuar dëme mbi shëndetin e njerëzve dhe/ose mjedisin;
- j. **“instalim”** është një njësi teknike brenda ndërmarrjes, ku prodhohen, përdoren, trajtohen, magazinohen apo duhet të prodhohen, përdoren, trajtohen, magazinohen substanca të rrezikshme, dhe përfshin
  - i. pajisjet, strukturat, sistemin e tubacioneve, makineritë dhe veglat,
  - ii. binarët rezervë të hekurudhave, doket dhe kalatat e shkarkimit që i shërbejnë instalimit, dhe
  - iii. bankinat, magazinat apo strukturat e ngjashme, pluskuese apo jo, dhe që janë të nevojshme për operimin e njësisë;
- k. **“ndërmarrje e nivelit më të ulët”** është ndërmarrja ku një nga substancat e rrezikshme të listuara në kolonën 1 të Pjesëve 1 ose 2 të Aneksit I është e pranishme në sasi të njëjtë apo më të madhe se sasia e listuar për atë substancë të rrezikshme në kolonën 2 të këtyre Pjesëve, por në sasi më të vogël sesa ajo e listuar për substancat e rrezikshme në kolonën 3 të këtyre Pjesëve;
- l. **“aksident madhor”** është ngjarja (që përfshin në veçanti një shkarkim, zjarr apo shpërthim madhor) që rezulton nga zhvillime të pakontrolluara në rrjedhën e operimit të çdo ndërmarrje që është subjekt i këtij Ligji, dhe që çon në rrezik serioz, të menjëhershëm apo të vonuar, brenda apo jashtë ndërmarrjes, për shëndetin e njeriut dhe/ose mjedisin dhe që shkaktohet nga një ose më shumë substanca të rrezikshme;
- m. **“Ministritë”** janë Ministria përgjegjëse për punën dhe sigurinë në punën ministria përgjegjëse për emergjencat civile, ministria përgjegjëse për shëndetsinë dhe Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, kurse **“Ministrat”** janë Ministrat përkatës;
- n. **“ndërmarrje e re”** është ndërmarrja, mbi të cilën pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji, për shkak të çfarëdo rritje në sasinë e substancave të rrezikshme të pranishme aty, bëhet subjekt i çdo Neni të këtij Ligji.
- o. **“operator”** është personi fizik apo juridik, i lejuar nga legjislacioni në fuqi për të ushtruar aktivitet tregtar, që kontrollon funksionimin e ndërmarrjes apo instalimit, apo të cilit i është dhënë fuqi ekonomike vendimtare për operimin teknik të tyre;

- p. **“risk”** është probabiliteti i ngjarjes së një efekti specifik brenda një periudhe të caktuar ose në rrethana të caktuara;
  - q. **“magazininim”** është prezenca e sasisë së substancave të rrezikshme për qëllime ruajtje, depozitimi të sigurt ose mbajtje në gjendje stoku.
  - r. **“ndërmarrje e nivelit më të lartë”** është ndërmarrja ku një substancë e rrezikshme e listuar në kolonën 1 të Pjesëve 1 ose 2 të Aneksit I është e pranishme në sasi të barabartë ose më të madhe se sasia e listuar për atë substancë të rrezikshme në kolonën 3 të këtyre Pjesëve.
  - s. **“Njësia e qeverisjes vendore”** ka kuptimin që i jepet nga ligji nr \_\_\_\_”Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”
2. Çdo referencë që i bëhet në këtë Ligj pranisë së substancave të rrezikshme në ndërmarrje nënkupton praninë aktuale apo të parashikuar të tyre apo praninë e tyre në sasi të barabartë apo më të madhe se pragjet e përcaktuar në Pjesët 1 dhe 2 të Aneksit 1, që ka arsye të besohet se mund të shkaktohet në rast aksidenti.
  3. Për qëllime të këtij Ligji dhe për sa i përket një ndërmarrje të re, cdo referencë mbi fillimin e operimit të ndërmarrjes, do të konsiderohet se i referohet kohës kur ndërmarrja e re u bë fillimisht e tillë.

Pas përfundimit të ToC të renditen përkufizimet në rend alfabetik. Aktualisht janë përkthyer dhe janë lënë në rendin alfabetik në anglisht për të lehtësuar kontrollin për ToC.

### **Neni 3. Autoritetet Kompetente.**

1. Ministria përgjegjëse për punën, shëndetin dhe sigurinë në punë,
  2. Ministria përgjegjëse për emergjencat civile (Departamenti i planizimit dhe I përballimit të emergjencave civile).
  3. Ministria përgjegjëse për shëndetin.
  4. Ministria përgjegjëse për mjedisin, duke vepruar brenda sferave të kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji (këtej e tutje të quajtura bashkarisht “Autoriteti Kompetent”).
  5. Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit
  6. Inspektoriati Shtetëror i Punës,
  7. Inspektorati sanitary shtetëror
- duke vepruar brenda kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjës për inspektimin dhe respektimin e këtij Ligji (këtej e tutje të quajtur bashkarisht “Autoriteti i Inspektimit”).

### **Neni 4. Objekti**

1. Ky Ligj zbatohet për të gjitha ndërmarrjet e nivelit më të lartë apo më të ulët, me përjashtim të Neneve 9-15, të cilat zbatohen vetëm për ndërmarrjet e nivelit më të lartë.
2. Ky Ligj zbatohet pavarësisht legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit publik, legjislacionit për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe legjislacionit për emergjencat civile.

3. Në rastet kur, për arsye të ndonjë ndryshimi në:
  - a. Klasifikimin e një substance të rrezikshme (referuar shënimit 1 të Pjesës 2 të Aneksit I); ose
  - b. Dijet mbi llojet e substancave të rrezikshme që mund të gjenerohen kur humbet kontrolli ndaj një procesi kimik industrial;sipërfaqja e tokës mbi të cilën është e pranishme substanca e rrezikshme, pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji konsiderohet si ndërmarrje e re. Operatori i kësaj ndërmarrje të re detyrohet që brenda tre muajve pas bërjes efektiv të ndryshimit të përmendur në gjermën a ose b të këtij paragrafi, të zbatojë cdo kërkesë të këtij Ligji që operatori duhet ta plotësojë përpara fillimit të operimit të ndërmarrjes.

## **Neni 5. Përjashtime**

1. Ky Ligj nuk zbatohet për:
  - a. Ndërmarrjet, instalimet apo impjantet magazinuese ushtarake;
  - b. Rreziqet e shkaktuara nga rrezatimi jonizues;
  - c. Transportin e këtyre substancave të rrezikshme dhe magazinimin e ndërmjetëm e të përkohshëm të tyre në rrugë automobilistike, hekurudhore, ujore të brendshme, detare ose ajrore, jashtë ndërmarrjeve që trajtohen nga ky Ligj, përfshirë ngarkimin, shkarkimin dhe transportin për në dhe nga mjete të tjera transporti në doke, skela dhe depo hekurudhore;
  - d. Transportin e këtyre substancave të rrezikshme përmes tubacioneve apo stacioneve të pompimit jashtë ndërmarrjeve të trajtuara nga ky Ligj;
  - e. Aktivitetet e industrive nxjerrëse lidhur me eksplorimin, nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve nga minierat dhe guroret ose nga pusët, me përjashtim të operacioneve të përpunimit kimik dhe termik dhe magazinimit lidhur me këto operacione që përfshijnë substanca të rrezikshme;
  - f. Aktivitetet e industrive nxjerrëse në det lidhur me eksplorimin, nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve përfshirë hidrokarburet;
  - g. Territoret e lëndfilleve të mbetjeve, me përjashtim të impjanteve të asgjësimit të mbetjeve minerare që janë funksionale, përfshirë pellgjet ose digat me mbetje minerare, që përmbajnë substanca të rrezikshme, sidomos kur përdoren për përpunimin kimik dhe termik të mineraleve.

## ***Kreu 2. Detyrime të Përgjithshme***

### **Neni 6. Detyrat e Përgjithshme të operatorit**

1. Operatori merr masat e nevojshme për parandalimin e aksidenteve madhore mbi njerëzit dhe mjedisin.
2. Operatori detyrohet t'i provojë Autoritetit Kompetent dhe/ose Autoritetit të Inspektimit sic parashikohet në nenin 22 në çdo kohë dhe në veçanti për qëllimet e inspektimit dhe investigimit të parashtruar në Nenin 22, se ka marrë të gjitha masat e nevojshme që kërkohen nga ky Ligj.

## Neni 7. Njoftimet

1. Operatori i ndërmarrjes, jo më vonë se gjashtë muaj përpara fillimit të ndërtimit të një ndërmarrje të re, i njofton Autoritetit Kompetent informacionin e specifikuar në Paragrafin 4.
2. Operatori i ndërmarrjes, brenda një periudhe kohe të arsyeshme, gjithsesi jo më vonë se tre muaj përpara fillimit të operimit të një ndërmarrje të re, i njofton Autoritetit Kompetent informacionin e specifikuar në Paragrafin 4, me përjashtim të informacionit që ndërkohë i ka dërguar në zbatim të Paragrafit 1, nëqse ai është ende i vlefshëm.
3. Operatori i cdo ndërmarrje ekzistuese, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, i njofton Autoritetit Kompetent informacionin e specifikuar në Paragrafin 4.
4. Informacioni i kërkuar nga Paragrafët 1, 2 ose 3 përfshin:
  - a. emrin ose emrin tregtar të operatorit dhe selinë/qendren me adresën e plotë të ndërmarrjes në fjalë;
  - b. NIPT/ vendin e regjistrimit të biznesit të operatorit, me adresën e plotë;
  - c. Te dhenat e perfqesuesit ligjor (emrin ose pozicionin e personit përgjegjës për ndërmarrjen), nëqse është i ndryshëm nga sa përcaktohet në shkronjën (a);
  - d. informacion të mjaftueshëm për identifikimin e substancave të rrezikshme ose kategorinë e substancave të rrezikshme që përdor;
  - e. sasinë dhe formën fizike të substancës apo substancave të rrezikshme që përdor;
  - f. përshkrimin e aktivitetit apo të aktivitetit të propozuar të instalimit apo impjantit të magazinimit;
  - g. hollësi mbi elementët e mjedisit të afërt të ndërmarrjes që kanë mundësi të shkaktojnë një aksident madhor apo për të përkeqësuar pasojat që rezultojnë nga një aksident i tillë.
5. Operatori njofton menjëherë me shkrim dhe jo më vonë se \_\_\_\_dite nga konstatimi Autoritetin Kompetent në rast se:
  - a. është rritur ndjeshëm sasia e substancave të rrezikshme të përcaktuara në këtë Nen;
  - b. ndodh një ndryshim i rëndësishëm në:
    - (i) natyrën apo formën fizike të substancave të rrezikshme të përcaktuara si të tilla,
    - (ii) proceset që i përdorin ato, ose
    - (iii) ndonjë informacion tjetër që i është dhënë Autoritetit Kompetent për atë ndërmarrje;
  - c. Neni 9 për raportet mbi sigurinë nuk mund të zbatohet më për atë ndërmarrje për shkak të ndryshimit të sasisë së substancave të rrezikshme që janë të pranishme aty;
  - d. bëhet ndonjë modifikim në ndërmarrje apo në ndonjë instalim të saj, i cili mund të ketë pasoja të konsiderueshme në rrezikun për aksidente madhore; ose
  - e. mbyllet përgjithmonë një instalim i asaj ndërmarrje.

6. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton formatin e njoftimeve të kërkuara sipas këtij ligji.

### **Neni 8. Politikat për parandalimin e aksidenteve madhore**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të ulët përgatit dhe mban një dokument që përcakton politikën e tij në lidhje me parandalimin e aksidenteve madhore (dokumenti i politikës së parandalimit të aksidenteve).
2. Politika e referuar në Paragrafin 1 hartohet në mënyrë të tillë që me mjetet, strukturat dhe sistemet e duhura të menaxhimit të garantojë një nivel të lartë mbrojtjeje për njerëzit dhe mjedisin.
3. Dokumenti i politikës së parandalimit të aksidenteve:
  - a. Merr parasysh parimet e specifikuar në Paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit II; dhe
  - b. Përfshin hollësi të mjaftueshme që demonstronë se operatori ka krijuar një sistem menaxhimi të sigurisë që merr parasysh parimet e specifikuar në Paragrafët 3 dhe 4 të Aneksit II.
4. Ndërmarrjet e reja të nivelit më të ulët përgatitin brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij Ligji dokumentin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore.
5. Operatori, nëqse modifikimi i ndërmarrjes apo instalimit të nivelit më të ulët, i procesit, i natyrës apo i sasisë së substancave të rrezikshme të pranishme atje mund (në çdo rast) të ketë pasoja të konsiderueshme mbi parandalimin e aksidenteve madhore, ri-shqyrton dhe nëqse është e nevojshme përditëson dokumentin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore.
6. Operatori zbaton politikën e përcaktuar në dokumentin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore.
7. Operatori e vë Dokumentin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore në dispozicion të Autoritetit Kompetent dhe Autoritetit të Inspektimit.

### ***Kreu 3. Raportet për Sigurinë***

#### **Neni 9. Raporti për Sigurinë**

1. Operatori, subjekt i Paragrafit 11, brenda një periudhe të arsyeshme kohe \_\_\_\_\_ muaj përpara fillimit të ndërtimit të një ndërmarrje të nivelit më të lartë, i dërgon Autoritetit Kompetent një raport me informacion të mjaftueshëm për qëllimin e specifikuar në Paragrafin 3(a) të Pjesës 1 të Aneksit III dhe të paktën me informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të Aneksit III që ka lidhje me atë qëllim.
2. Raporti i referuar në Paragrafin 1 mund të përbëhet nga më shumë se një dokument që i dërgohen Autoritetit Kompetent në kohë të ndryshme brenda periudhës së referuar në atë paragraf.
3. Paragrafi 1 nuk kërkon që raporti të përmbajë informacione që operatori nuk mund t'i ketë në kohën e dërgimit të raportit.
4. Operatori, pavarësisht nga kërkesat e Nenit 21 për ndalimin e përdorimit, siguron që ndërtimi i ndërmarrjes së nivelit më të lartë nuk do të fillojë para se ai të ketë marrë mendimin me shkrim të Autoritetit Kompetent pas shqyrtimit të raportit të dërguar sipas Paragrafit 1.



5. Operatori, subjekt i Paragrafit 11, brenda një perudhe të arsyeshme kohe \_\_\_\_\_ muaj përpara fillimit të ndërtimit të një ndërmarrje të nivelit më të lartë, i dërgon Autoritetit Kompetent një raport me informacion të mjaftueshëm për qëllimet e specifikuar në Pjesën 1 të Aneksit III dhe përfshin të paktën informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të Aneksit III, me përjashtim të informacionit të përfshirë në raportin e dërguar sipas Paragrafit 1, nëse ky informacion është ende i vlefshëm.
6. Operatori, pavarësisht nga kërkesat e Nenit 21 për ndalimin e përdorimit, siguron që ndërtimi i ndërmarrjes së nivelit më të lartë nuk do të fillojë para se ai të ketë marrë mendimin me shkrim të Autoritetit Kompetent pas shqyrtimit të raportit të dërguar sipas Paragrafit 4.
7. Operatori i ndërmarrjes ekzistuese të nivelit më të lartë, subjekt i Paragrafit 11, brenda 2 vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, i dërgon Autoritetit Kompetent një raport me informacion të mjaftueshëm për qëllimet e specifikuar në Pjesën 1 të Aneksit III dhe të paktën me informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të Aneksit III.
8. Operatori i ndërmarrjes së re të nivelit më të lartë, subjekt i Paragrafit 11, i dërgon Autoritetit Kompetent brenda një viti pas datës kur ky Ligj zbatohet për atë ndërmarrje, një raport me informacion të mjaftueshëm për qëllimet e specifikuar në Pjesën 1 të Aneksit III dhe të paktën me informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të Aneksit III.
9. Operatori, pavarësisht nga kërkesat e Nenit 21 për ndalimin e përdorimit, siguron që operimi i ndërmarrjes së nivelit më të lartë, për të cilën zbatohen Paragrafët 7 ose 8, nuk vazhdon pas datës së referuar në këto Paragrafë, derisa ai të ketë marrë përfundimet e Autoritetit Kompetent nga shqyrtimi i raportit të dërguar sipas Paragrafëve 7 dhe 8, sipas rastit.
10. Operatori, të gjithë informacionin që kërkohet në raportin për sigurinë ose pjesë të tij, mund ta përfshijë duke i bërë referencë informacionit të dhënë në një raport tjetër që ja ka dërguar Autoritetit Kompetent sipas kërkesave të legjislacioneve të tjera.
11. Autoriteti Kompetent mund të pranojë të kufizojë informacionin që kërkon në raportin për sigurinë e ndërmarrjes për çështjet që kanë të bëjnë me parandalimin e rreziqeve të aksidenteve madhore të mbetura dhe me kufizimin e pasojave të tyre për njerëzit dhe mjedisin nëse operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë i demonstron në mënyrë bindëse, me shkrim dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në Pjesën 3 të Aneksit III, se disa substanca të rrezikshme të veçanta ose ndonjë pjesë e tyre, që janë të pranishme në ndërmarrje, nuk janë në gjendje të krijojnë rrezik për aksidente madhore.
12. Operatori i dërgon Autoritetit Kompetent informacionin shtesë që ky mund t'i kërkojë në mënyrë të arsyeshme me shkrim pas shqyrtimit të raportit për sigurinë, brenda periudhës kohore të specifikuar në kërkesën në fjalë.
13. Autoriteti Kompetent e vë Raportin për Sigurinë, në dispozicion të publikut, me përjashtim të atij lloji informacioni i cili sipas legjislacionit në fuqi konsiderohet konfidencial apo i klasifikuar.
14. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrave, miraton rregullore për modelin, e hartimit të raportet për sigurinë.

## **Neni 10. Shqyrtimi dhe përditësimi i raportit për sigurinë**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë që i ka dërguar Autoritetit Kompetent raportin për sigurinë e ri-shqyrton atë:
  - a. të paktën çdo 5 vjet;
  - b. kurdo që është e nevojshme, me iniciativë të operatorit ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent, për shkak të fakteve të reja apo për të marrë në konsideratë njohuri të reja teknike rreth çështjeve të sigurisë, për shembull që rrjedhin nga analiza e aksidenteve, ose sa më shumë të jetë e mundur, ‘e aksidenteve të shmangura në momentin e fundit’, dhe shtimit të dijeve për vlerësimin e rreziqeve;
  - c. kurdo që operatori bën ndryshime në sistemin e menaxhimit të sigurisë të referuar në paragrafin 1 të Aneksit III, Pjesa 1, të cilat mund të kenë pasoja të konsiderueshme mbi parandalimin e aksidenteve madhore ose kufizimin e pasojave të aksidenteve madhore ndaj njerëzve dhe mjedisit; dhe kur si rrjedhojë e këtij ri-shqyrtimi është e nevojshme, operatori e përditëson menjëherë raportin për sigurinë dhe informon Autoritetin Kompetent për hollësitë e këtij përditësimi.
2. Operatori informon menjëherë Autoritetin Kompetent edhe në rast se, në bazë të Paragrafit 1(a), ka ri-shqyrtuar por nuk ka përditësuar raportin për sigurinë.
3. Operatori që propozon modifikime të ndërmarrjes apo instalimit të nivelit më të lartë, të procesit që kryhet atje, të natyrës apo sasisë së substancave të rrezikshme të pranishme dhe kur ky modifikim mund të ketë pasoja të konsiderueshme mbi parandalimin e aksidenteve madhore apo kufizimin e pasojave të aksidenteve madhore mbi njerëzit dhe mjedisin, përpara çdo modifikimi:
  - a. Ri-shqyrton, dhe kur është e nevojshme përditëson, raportin për sigurinë në lidhje me ndërmarrjen, instalimin, procesin apo substancat e rrezikshme sipas rastit; dhe
  - b. Informon Autoritetin Kompetent për detajet e këtij përditësimi.

## ***Kreu 4. Planet e Emergjencës***

### **Neni 11. Plani i brendshëm i emergjencës**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë përgatit një plan të brendshëm emergjence që siguron realizimin e objektivave të specifikuara në Pjesën 1 të Aneksit IV dhe përmban informacionin e specifikuar në Pjesën 2 të Aneksit IV.
2. Plani i brendshëm i emergjencës përgatitet:
  - a. në rastin e një ndërmarrje ekzistuese të nivelit më të lartë, brenda 2 vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji;
  - b. në rastin e një ndërmarrje të re të nivelit më të lartë, brenda 1 viti pasi kërkesat e këtij Ligji të zbatohen për atë ndërmarrje;
  - c. në çdo rast tjetër, përpara fillimit të operimit të ndërmarrjes së nivelit më të lartë.
3. Operatori, për përgatitjen e planit të brendshëm të emergjencës, konsultohet me:
  - a. personat që punojnë në ndërmarrje, përfshirë personat e nënkontraktuar për periudha të gjata kohe;
  - b. Autoritetin Kompetent;

- c. shërbimet e emergjencës; dhe
  - d. autoritetin shëndetësor të zonës ku ndodhet ndërmarrja;
4. Operatori për qelimin e specifikuar në paragrafin 3 konsultohet edhe me njësinë e qeverisjes vendore të zonës ku ndodhet ndërmarrja me përjashtim të rasteve kur, sipas Nenit 12.11, kjo njësi është përjashtuar nga kërkesa për të përgatitur një plan të jashtëm emergjence për atë ndërmarrje.
  5. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për planet e brendshme të emergjencës.

## **Neni 12. Plani i jashtëm i emergjencës**

1. Njësia e qeverisjes vendore e zonës ku ndodhet ndërmarrja e nivelit më të lartë përgatit një plan të jashtëm emergjence për atë ndërmarrje. Ky plan duhet të sigurojë arritjen e objektivave të specifikuara në Pjesën 1 të Aneksit IV dhe të përmbajë informacionin e specifikuar në Pjesën 3 të Aneksit IV.
2. Plani i jashtëm i emergjencës përgatitet jo më vonë se gjashtë muaj nga më e vonëshmjia midis:
  - a. Dates kur njësia e qeverisjes vendore ka marrë nga Autoriteti Kompetent njoftim se duhet të përgatisë një plan të jashtëm emergjence për ndërmarrjen;
  - b. Dates kur kërkohet të përgatitet plani i brendshëm i emergjencës për ndërmarrjen sipas Nenit 11; ose
  - c. Dates kur njësia e qeverisjes vendore ka marrë informacionin e referuar në Paragrafët 3 dhe 5;
3. Operatori i jep njësisë së qeverisjes vendore të zonës ku ndodhet ndërmarrja informacionin e nevojshëm që mundëson njësinë e qeverisjes vendore të përgatisë planin e jashtëm të emergjencës.
4. Informacioni i referuar në Paragrafin 3 ofrohet jo më vonë se koha e përcaktuar në nenin 11 për përgatitjen e planit të brendshëm të emergjencës nga ajo ndërmarrje.
5. Operatori i jep njësisë së qeverisjes vendore çdo informacion të arsyeshëm shtesë që kjo mund të kërkojë me shkrim për të mundësuar përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës, brenda periudhës kohore që specifikohet në kërkesë.
6. Njësia e qeverisjes vendore, për përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës, konsultohet me operatorin, Autoritetin Kompetent, shërbimet e emergjencës dhe autoritetin shëndetësor të zonës ku ndodhet ndërmarrja.
7. Njësia e qeverisjes vendore, për përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës, pavarësisht nga dispozitat e Paragrafit 6 konsultohet me anëtarë të publikut që i konsideron të përshtatshëm.
8. Njësia e qeverisjes vendore, për përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës, pavarësisht nga dispozitat e Paragrafit 6 mund të konsultohet gjithashtu edhe me njësitë fqinje të qeverisjes vendore që kanë gjasa të ndikohen nga aksidentet madhore në ndërmarrje.
9. Njësia e qeverisjes vendore pas marrjes së informacionit të referuar në Paragrafët 3 dhe 5 dhe pas konsultimeve të referuara në Paragrafët 6, 7 dhe 8 përgatit projekt planin e jashtëm të emergjencës dhe e vë në dispozicion të publikut për një periudhë kohe jo më pak se 30 ditë. Gjatë kësaj kohe publiku mund t'i japë njësisë së qeverisjes vendore komentet e veta me shkrim.

10. Njësia e qeverisjes vendore, pasi ka marrë në konsideratë komentet e publikut sipas Paragrafit 9, përgatit versionin përfundimtar të planit të jashtëm të emergjencës.
11. Autoriteti Kompetent, në varësi të informacionit të përfshirë në raportin për sigurinë, mund të përjashtojë njësinë e qeverisjes vendore nga kërkesa për përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës për një ndërmarrje, përmes një dokumenti me shkrim ku konstaton edhe kohëzgjatjen dhe arsyet përkatëse.
12. Njësia e qeverisjes vendore, të cilës sipas Paragrafit 11 i është bërë një përjashtim dhe ky është në fuqi, nuk ka asnjë funksion në lidhje me përgatitjen, shqyrtimin, testimin dhe vënien në zbatim të planit të jashtëm të emergjencës për ndërmarrjen në fjalë.
13. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për planet e jashtme të emergjencës.

### **Neni 13. Shqyrtimi dhe testimi i planeve të emergjencës**

1. Personi që ka përgatitur një plan emergjence sipas këtij Ligji, në intervale të përshtatshëm por që nuk i tejkalojnë 3 vjet:
  - a. ri-shqyrton dhe, ku është e nevojshme, përditëson planin; dhe
  - b. teston planin dhe merr hapat e duhur për organizimin e shërbimeve të emergjencës që të marrin pjesë në testim në atë shkallë që është e nevojshme;
2. Cdo ri-shqyrtim i tillë merr në konsideratë ndryshimet që ndodhin në ndërmarrjen me të cilin lidhet plani, në shërbimet e emergjencës, në njohuritë e reja teknike dhe njohuritë mbi reagimin ndaj aksidenteve madhore.
3. Njësitë e qeverisjes vendore kane te drejte te lidhin marrëveshje me operatorin dhe shërbimet e emergjencës për te percaktuar mënyrën se si do të testohet plani i jashtëm i emergjencës.

### **Neni 14. Zbatimi i planeve të emergjencës**

1. Personi që ka përgatitur planin e emergjencës sipas këtij Ligji, merr të gjitha masat e nevojshme për ta vënë atë në zbatim pa vonesë kur ndodh:
  - a. një aksident madhor; ose
  - b. një ngjarje e pakontrolluar, e cila, për shkak të natyrës së vet, llogjikisht mund të pritet të çojë drejt një aksidenti madhor.

## ***Kreu 5. Informacioni***

### **Neni 15. Dhënia e informacionit nga operatori për publikun**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë siguron që:
  - a. të gjithë personave që mund të gjënden në zonën e referuar në Paragrafin 2; dhe
  - b. të gjitha ndërmarrjeve të shërbimeve publike (siç janë shkollat dhe spitalet) që ndodhen në zonën e referuar në Paragrafin 2;t'i jepet rregullisht dhe në formën më të përshtatshme informacion për masat e sigurisë në ndërmarrje dhe se si duhet të veprojnë në rast të një aksidenti madhor në ndërmarrje pa qenë nevoja që këta ta kërkojnë atë.

2. Zona e referuar në Paragrafin 1 është zona që Autoriteti Kompetent ja ka njoftuar operatorit si një zonë ku, sipas mendimit të tij, personat janë të predispozuar të ndikohen nga aksidentet madhore që ndodhin në ndërmarrje.
3. Operatori vë në dispozicion të publikut informacionin e referuar në Paragrafin 1.
4. Informacioni i referuar në Paragrafin 1 përmban të paktën informacionin e specifikuar në Aneksin V.
5. Operatori, gjatë përgatitjes së informacionit që kërkohet nga Paragrafi 1, konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore të zonës ku ndodhet ndërmarrja dhe persona të tjerë që ai i vlerëson si të përshtatshëm, por operatori mbetet përgjegjës për saktësinë, plotësinë dhe formën e informacionit të dhënë.
6. Operatori ri-shqyrton, dhe kur është e nevojshme, përditëson informacionin e referuar në Paragrafin 1:
  - a. Në intervale kohe që nuk tejkalojnë 3 vjet;
  - b. Kur ndodh modifikimi i referuar në Nenin 8 përsa i përket politikës së parandalimit të aksidenteve madhore; ose
  - c. Kur ndodh modifikimi i referuar në Nenin 9 përsa i përket raporteve për sigurinë.
7. Operatori siguron që informacioni të jepet në përputhje me Paragrafin 1 brenda një periudhe të arsyeshme kohe (prej \_\_\_\_ ditësh) pasi është përgatitur plani i jashtëm i emergjencës për ndërmarrjen, dhe të ri-jepet:
  - a. Në intervale kohe që nuk tejkalojnë 5 vjet; ose
  - b. Nqse ky plan është ri-shqyrtuar dhe përditësuar sipas Paragrafit 6.
8. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për Informimin Publik në zbatim të këtij neni.

## **Neni 16. Informimi i Autoriteteve nga operatori**

1. Operatori i ndërmarrjes, i jep Autoritetit Kompetent ose Autoritetit të Inspektimit informacion të mjaftueshëm për të demonstruar që ai ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të respektuar këtë Ligj, kur një gjë e tillë i kërkohet prej tyre dhe brenda periudhës kohore të specifikuar në kërkesë.
2. Operatori, pavarësisht nga parimet e përgjithshme të Paragrafit 1, me kërkesë të Autoritetit Kompetent ose Autoritetit të Inspektimit dhe brenda periudhës kohore të specifikuar në kërkesë, vë në dispozicion çdo informacion të nevojshëm që e mundëson atë Autoritet të:
  - a. Vlerësojë plotësisht mundësinë për një aksident madhor dhe të përcaktojë mundësinë e rritjes së probabilitetit dhe/ose të përkeqësimit të një aksidenti madhor;
  - b. Marrë parasysh substancat të cilat, për shkak të formës së tyre fizike, vendndodhjes apo kushteve të veçanta, mund të kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm; ose
  - c. Kryejë funksionet e tij për të përfutur ose grumbulluar informacion sipas Paragrafit 4;
3. Operatori, kur ndodh një aksident madhor në ndërmarrje, informon menjëherë Autoritetin Kompetent dhe Autoritetin e Inspektimit për aksidentin që ka ndodhur.

4. Operatori, kur ndodh një aksident madhor në ndërmarrje, i jep informacion Autoritetit Kompetent dhe Autoritetit të Inspektimit sapo informacioni të jetë i disponueshëm.
5. Informacioni i referuar në Paragrafin 4 përfshin:
  - a. Rrethanat e aksidentit;
  - b. Substancat e rrezikshme të përfshira;
  - c. Të dhënat e disponueshme për vlerësimin e efekteve të aksidentit mbi njerëzit dhe mjedisin;
  - d. Masat e emergjencës që janë ndërmarrë;
  - e. Hapat e parashikuara:
    - i. për të lehtësuar efektet afat-mesme dhe afat-gjata të aksidentit
    - ii. për të parandaluar çdo përsëritje të aksidenteve të tillë.
6. Operatori përditëson informacionin e referuar në Paragrafin 4 nqse investigimi i mëtejshëm zbulon fakte të tjera që e ndryshojnë informacionin apo përfundimet e nxjerra nga ai informacion.

### **Neni 17. Informimi i ndërmarrjeve të tjera nga Autoriteti Kompetent**

1. Autoriteti Kompetent duke përdorur informacionin e marrë nga operatorët në njoftimet e dërguara sipas Nenit 7 dhe raporteve për sigurinë sipas Nenit 9, shpall grupet e ndërmarrjeve ku gjasat apo pasojat e aksidenteve madhore mund të rriten për shkak të vendndodhjes dhe afërsisë së këtyre ndërmarrjeve dhe substancave të rrezikshme të pranishme aty.
2. Autoriteti Kompetent i bën të ditur të gjithë operatorëve të ndërmarrjeve të një grupi të shpallur sipas Paragrafit 1, emrat dhe adresat e ndërmarrjeve të tjera të të njëjtit grup.
3. Operatori i ndërmarrjes që bën pjesë në një grup të shpallur sipas Paragrafit 1:
  - a. I jep operatorëve të të gjitha ndërmarrjeve të tjera të grupit informacionin e duhur për ndërmarrjen që t'ju mundësojë atyre të marrin në konsideratë natyrën dhe shkallën e rrezikut të përgjithshëm të aksidenteve madhore në dokumentet e tyre të politikës së parandalimit të aksidenteve madhore, sistemet e menaxhimit të sigurisë, raportet për sigurinë dhe planet e brendshme të emergjencës; dhe
  - b. Bashkëpunon me ndërmarrjet e tjera për t'i mundësuar atyre përmbushjen e detyrimeve që kanë për dhënien e informacionit njësisive të qeverisjes vendore për planet e jashtme të emergjencës sipas Nenit 12 apo për informimin e publikut sipas Nenit 15.

## ***Kreu 6 Detyrat e Autoritetit Kompetent***

### **Neni 18 Ekzaminimi i raportit për sigurinë**

1. Autoriteti Kompetent, brenda një periudhe të arsyeshme kohe, por jo me vone se tre muaj, nga marrja e raportit për sigurinë sipas Nenit 9:
  - a. I komunikon operatorit të ndërmarrjes në fjalë përfundimet e tij nga shqyrtimi i raportit për sigurinë; ose
  - b. Ndalon operimin apo vënien në funksionim të ndërmarrjes ose instalimit në fjalë, apo të ndonjë pjese të tyre, sipas Nenit 21.

## **Neni 19 Efektet ndërkufitare**

1. Autoriteti Kompetent, kur gjykon se mundësia për një aksident madhor në një ndërmarrje për të cilin gjen zbatim Neni 9 mund të ketë efekte ndërkufitare, i dërgon Autoritetit Kompetent të Shtetit potencialisht të ndikueshëm informacion të mjaftueshëm që e mundëson atë të përgatisë një plan të jashtëm emergjence dhe të informojë publikun e vet në mënyrën më të përshtatshme për të.
2. Autoriteti Kompetent, kur vendos që njësitë e qeverisjes vendore të zonës ku ndodhet ndërmarrja të përjashtohet nga hartimi i raportit të jashtëm të emergjencës sipas Nenit 12(11), dhe kur ndërmarrja është afër me territorin e një Shteti tjetër, Autoriteti Kompetent informon Autoritetin Kompetent të atij Shteti.
3. Autoriteti Kompetent, kur merr informacion mbi një ndërmarrje nga një Shtet tjetër, zbaton dispozitat e Nenit 12 (raporti i jashtëm i emergjencës) dhe 15 (informacioni për masat e sigurisë) sikur ai informacion të ishte marrë në mbështetje të Nenit 9, me kusht që çdo referencë ndaj operatorit në Nenin 15 të interpretohet si referencë ndaj Autoritetit Kompetent.

## **Neni 20 Regjistri**

1. Autoriteti Kompetent mban një regjistër ku shënon informacionin e përfshirë në:
  - a. Njoftimet sipas Nenit 7;
  - b. Raportet për sigurinë sipas Nenit 9;
  - c. Njoftimet sipas Nenit 17(2); dhe
  - d. Komunikimet sipas Nenit 18.
2. Autoriteti Kompetent mund të heqë nga regjistri informacionin për një ndërmarrje 5 vjet pas kohës kur ajo pushon së qeni subjekt i këtij Ligji.
3. Autoriteti Kompetent, kur një informacion i cfarëdo lloji përjashtohet nga regjistri për shkak të legjislacionit të veçantë për konfidencialitetin, bën në regjistër një deklaratë që tregon se informacioni i atij lloji ekziston.
4. Autoriteti Kompetent, nuk mund të përfshijë në regjistër asnjë informacion nqse dhe për aq kohë sa gjykon se përfshirja e atij informacioni ose e informacionit të atij lloji në regjistër, bie ndesh me interesat e sigurisë kombëtare.
5. Regjistri përmban informacion për aksidentet madhore që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Aneksin VI. Ky informacion përfshin:
  - a. Datën, orën dhe vendin e aksidentit madhor;
  - b. Emrin e plotë të operatorit;
  - c. Adresën e ndërmarrjes në fjalë;
  - d. Një përshkrim të përmbledhur të rrethanave të aksidentit, përfshirë substancat e rrezikshme që e kanë shkaktuar, dhe efektet e menjëhershme mbi njerëzit dhe mjedisin;
  - e. Një përshkrim të përmbledhur të masave të emergjencës të ndërmarrja; dhe
  - f. Masat paraprake të nevojshme për të parandaluar përsëritjen e tij.
6. Regjistri mund të mbahet në çdo lloj forme.
7. Autoriteti Kompetent ka për detyrë:
  - a. Të sigurojë që regjistri është i disponueshëm për publikun falas dhe brenda orarit normal të punës; dhe
  - b. T'i krijojë mundësi publikut mundësi për të marrë kopjet e të dhënave, në bazë të pagesës së një tarife të arsyeshme.

## **Neni 21 Ndalimi i operimit**

1. Autoriteti Kompetent ndalon operimin apo vënien në funksionim të ndërmarrjes, instalimit apo pjesëve të tyre, nëqse masat e ndërmarrja nga operatori për parandalimin dhe zbutjen e aksidenteve madhore janë seriozisht të mangëta.
2. Autoriteti Kompetent mund të ndalojë operimin apo vënien në funksionim të ndërmarrjes, instalimit apo pjesëve të tyre, nëqse operatori nuk ka dërguar njoftim, raport për sigurinë apo informacion tjetër të kërkuar sipas këtij Ligji brenda kohës së specifikuar.
3. Autoriteti Kompetent, kur propozon ndalimin e operimit apo vënies në funksionim të një ndërmarrje, instalimi apo pjesëve të tyre sipas Paragrafit 1, i dërgon operatorit një njoftim me shkrim ku specifikon arsyet dhe datën kur ky ndalim do të hyjë në fuqi. Ky njoftim, sipas rastit, mund të anulohet me shkrim nga Autoriteti Kompetent.
4. Njoftimi i dërguar në mbështetje të Paragrafit 3 mund të specifikojë masa të cilat, nëqse ndërmerren nga operatori, do ta bënin Autoritetin Kompetent të anulonte njoftimin.
5. Operatori, kur merr njoftim sipas Paragrafit 3, respekton kërkesat e tij.

## **Neni 22 Inspektimet dhe investigimet**

1. Autoriteti i Inspektimit organizon një sistem inspektimi ose masash të tjera kontrolli specifik të përshtatshme për tipin e ndërmarrjes.
2. Inspektimet ose masat e kontrollit të referuara në Paragrafin 1 nuk duhet të varen nga marrja e raporteve për sigurinë apo raporteve të tjera të dorëzuara nga operatori. Ato duhet të jenë të mjaftueshme për një ekzaminim të planifikuar dhe sistematik të sistemeve që përdoren në ndërmarrje, pavarësisht nga natyra teknike, organizative apo e menaxhimit, në mënyrë që të sigurohet në veçanti që:
  - a. operatori verteton/provon që ka marrë masat e përshtatshme në lidhje me aktivitetet e ndryshme të përfshira në ndërmarrje, për të parandaluar aksidentet madhore;
  - b. operatori verteton/provon që ka siguruar mjetet e përshtatshme për kufizimin e pasojave nga aksidentet madhore, si brenda ashtu edhe jashtë ndërmarrjes;
  - c. të dhënat dhe informacioni që përmbahen në raportin për sigurinë, ose në çdo raport tjetër që operatori i ndërmarrjes ka dorëzuar tek Autoriteti Kompetent dhe/ose Autoriteti i Inspektimit, reflektojnë mjaftueshëm kushtet e ndërmarrjes; dhe
  - d. operatori i ka dhënë publikut informacionin sipas Nenit 15.
3. Sistemi i inspektimit i referuar në Paragrafin 1 plotëson kushtet e mëposhtme:
  - a. ka një program për inspektimin e të gjitha ndërmarrjeve;
  - b. nëqse një program i tillë nuk është bazuar në një vlerësim sistematik të rreziqeve nga aksidentet madhore të cdo ndërmarrje të veçantë, programi duhet të sigurojë të paktën një inspektim në vend në çdo dymbëdhjetë muaj për secilën ndërmarrje që është subjekt i kërkesave të Nenit 9 për raportin për sigurinë;
  - c. Autoriteti i Inspektimit përgatit një raport pas çdo inspektimi; dhe



- d. Operatori dhe menaxhimi i ndërmarrjes, kur është e nevojshme, duhet të vazhdojnë inspektimin e kryer nga Autoriteti i Inspektimit për një periudhë të arsyeshme kohe pas inspektimit.
4. Autoriteti i Inspektimit, kur njoftohet për një aksident madhor në një ndërmarrje:
  - a. Siguron që janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme urgjente, afat-mesme dhe afat-gjata;
  - b. Bën një analizë të plotë të aspekteve teknike, organizative dhe menaxheriale të aksidenteve madhore dhe grumbullon, nëpërmjet inspektimit, investigimit apo mjeteve të tjera të përshtatshme, informacionin e nevojshëm për atë qëllim;
  - c. Ndërmerr veprimet e duhura për të siguruar që operatori merr të gjitha masat e nevojshme korrigjuese; dhe
  - d. Bën rekomandime për masa të ardhshme parandaluese.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për inspektimet.

## ***Kreu 7. Planifikimi i përdorimit të territorit***

### **Neni 23 Politikat e përdorimit të territorit**

1. Politikat e përdorimit të tokës dhe politikat e tjera të lidhura me to të zhvilluara nga autoritetet përkatëse sipas legjislacioneve të veçana marrin në konsideratë objektivat e parandalimit të aksidenteve madhore dhe kufizimit të pasojave të aksidenteve të tilla.
2. Objektivat e referuara në Paragrafin 1 ndiqen nëpërmjet kontrollit të:
  - a. Vend-ndodhjes së ndërmarrjeve të reja;
  - b. Modifikimit të ndërmarrjeve ekzistuese;
  - c. Zhvillimeve të reja si lidhjet e transportit, vendet e frekuentuara nga publiku dhe zonat e banuara në afërsi të ndërmarrjeve ekzistuese, ku vendndodhja apo zhvillimet janë të tilla që rrisin riskun apo pasojat e aksidenteve madhore.
3. Politikat e referuara në Paragrafin 1 dhe procedurat për zbatimin e këtyre politikave duhet të marrin në konsideratë nevojën afat-gjatë:
  - d. Për të mbajtur distanca të përshtatshme ndërmjet ndërmarrjeve të trajtuara nga ky Ligj dhe zonave të banuara, ndërtesave dhe zonave për përdorim publik, rrugëve kryesore të transportit për aq sa është e mundur, zonave rekreative dhe zonave me ndjeshmëri natyrore apo interes të veçantë; dhe
  - e. Në rastin e ndërmarrjeve ekzistuese, nevojën për masa teknike shtesë në përputhje me detyrimet e përgjithshme të operatorit sipas Nenit 6.
4. Autoritetet perkatese te planifikimit te territorit dhe autoritetet kompetente sipas ketij Ligji do te percaktojne procedura konsultimi qe lehtesojne zbatimin e politikave te perdorimit te territorit qe referohen ne kete nen. Keto procedura duhet te hartohen ne menyre te tille qe sa here merren vendime ne lidhje me perdorimin e territorit te sigurohet keshillim teknik mbi rreziqet qe mund te vijne nga ndermarrjet qe trajtohen nga ky ligj.
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për zbatimin e këtij Neni.

## **Neni 24 Konsultimi me Publikun**

1. Autoritetet kompetente për planifikimin e territorit dhe autoritetet kompetente sipas këtij ligj sigurojnë që publiku të ketë mundësi të japë mendimin e tij mbi propozimet për:
  - a. Planifikimin e ndërmarrjeve të nivelit më të lartë;
  - b. Modifikimet për ndërmarrjet ekzistuese;
  - c. Zhvillimet rreth ndërmarrjeve ekzistuese.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për zbatimin e këtij Neni.

## ***Kreu 8. Kundervajtjet dhe sanksionet administrative***

### **Neni 25 Kundervajtjet dhe sanksionet administrative**

1. Shkelja e mëposhtme është vepër penale:
  - a. Çdo person që sipas këtij Ligji ka për detyrë të japë informacion dhe që i jep informacion të rremë apo dizinformues Autoritetit Kompetent, Autoritetit të Inspektimit apo çdo autoriteti tjetër sipas këtij Ligji shpallet fajtor për vepër penale në bazë të Nenit 186 të Kodit Penal.
2. Për qëllime të këtij Ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e mëposhtme, konsiderohen si Kundervajtje administrative:
  - b. Operatori që nuk i dërgon Autoritetit Kompetent njoftimin që kërkohet nga Neni 7, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë dhe në mënyrë kumulative me \_\_\_\_\_ Lekë në ditë deri sa ky njoftim të merret nga AK;
  - c. Operatori që nuk i dërgon Autoritetit Kompetent njoftimin që kërkohet nga Neni 7 brenda kohës së kërkuar, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - d. Operatori që nuk informon Autoritetin Kompetent për faktet përkatëse në përputhje me Nenin 7(5) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë dhe në mënyrë kumulative me \_\_\_\_\_ Lekë në ditë deri sa ky informacion të merret nga AK;
  - e. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të ulët që nuk përgatit ose nuk zbaton politikën e parandalimit të aksidenteve madhore sipas Nenit 8, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - f. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të ulët që nuk rishqyrton dhe ku është e nevojshme nuk rishikon politikën e prandalimit të aksidenteve madhore sipas Nenit 8(5) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - g. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të ulët që nuk zbaton politikën e prandalimit të aksidenteve madhore sipas Nenit 8(6) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - h. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk i dërgon Autoritetit Kompetent Raportin për Sigurinë sipas Nenit 9, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - i. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk i dërgon Autoritetit Kompetent Raportin për Sigurinë sipas Nenit 9, ngarkohet me gjobë

- administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë dhe në mënyrë kumulative me \_\_\_\_\_ Lekë në ditë deri sa ky njoftim të merret nga AK;
- j. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk nuk i dërgon Autoritetit Kompetent Raportin për Sigurinë brenda periudhës kohore të kërkuar nga Neni 9, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - k. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që operon të gjithë ndërmarrjen apo pjesë të saj pa pritur përfundimet e nevojshme nga Autoriteti Kompetent siç kërkohet nga Neni 9, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - l. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk ri-shqyrton dhe nqse është e nevojshme nuk përditëson Raportin për Sigurinë sipas Nenit 10, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - m. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që modifikon ndërmarrjen pa ri-shqyrtuar më parë dhe nqse është e nevojshme pa përditësuar Raportin për Sigurinë sipas Nenit 10(3)(a), ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - n. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që modifikon ndërmarrjen pa informuar më parë Autoritetin Kompetent sipas Nenit 10(3)(b), ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - o. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk përgatit Planin e Brendshëm të Emergjencës sipas Nenit 11, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - p. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk i jep njësisë së qeverisjes vendore informacionin e nevojshëm për të përgatitur Planin e Jashtëm të Emergjencës sipas Nenit 12, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - q. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk ri-shqyrton dhe kur është e nevojshme nuk përditëson Planin e Brendshëm të Emergjencës sipas Nenit 13(1)(a) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - r. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk teston Planin e Brendshëm të Emergjencës sipas Nenit 13(1)(b) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - s. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk ndërmerr hapat e arsyeshme për të organizuar shërbimet e emergjencës të marrin pjesë në testimin e Planit të Brendshëm të Emergjencës sipas Nenit 13(1)(b) ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - t. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk zbaton Planin e Brendshëm të Emergjencës sipas Nenit 14 ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - u. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk i jep informacion publikut sipas Nenit 15 ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;

- v. Operatori i një ndërmarrje të nivelit më të lartë që nuk i jep informacion autoriteteve përkatëse sipas Nenit 16 ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë;
  - w. Operatori i një ndërmarrje që operon të gjithë apo pjese të ndërmarrjes që është subjekt i ndalimit të përdorimit sipas Nenit 21, ngarkohet me gjobë administrative nga \_\_\_\_\_ lekë në \_\_\_\_\_ lekë.
3. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e çliron subjektin, të cilit i drejtohet nga detyrimet e parashikuara nga ky ligj dhe nga përgjegjësia civile për dëmtime të shkaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## ***Kreu 9. Dispozita Përfundimtare***

### **Neni 26 Raportimi**

1. Ministritë përgatisin çdo tre vjet raport për zbatimin e këtij Ligji.
2. Informacioni i referuar në Paragrafin 1 minimalisht përmban:
  - a. Listën e ndërmarrjeve për të cilat zbatohet Neni 9(11), me arsye të përkatëse.
  - b. Emrin ose emrin tregtar të secilit operator, ndërmarrja e të cilit bën pjesë në listë;
  - c. Adresën e plotë të secilës ndërmarrje;
  - d. Aktivitetin ose aktivitetet e secilës ndërmarrje; dhe
3. Informacioni i referuar në Paragrafin 1 gjithashtu përmban informacionin e specifikuar në Aneksin VI për plotësimin e kriterëve të specifikuar në atë Aneks për të gjitha aksidentet madhore.
4. Informacioni i referuar në Paragrafin 1 gjithashtu përmban informacion për të gjitha analizat dhe rekomandimet e bëra në mbështetje të Nenit 22(4)(b) dhe (d).
5. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për raportimin.

### **Neni 27 Tarifat e Autoritetit Kompetent**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të ulët i paguan Autoritetit Kompetent një tarifë vjetore për .... lekë.
2. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë i paguan Autoritetit Kompetent një tarifë vjetore për .... Lekë.
3. Vlerat e tarifave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij Neni miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit.

### **Neni 28. Tarifat për njësinë e qeverisjes vendore**

1. Operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë i paguan njësisë përkatëse të qeverisjes vendore një tarifë kur ajo teston Planin përkatës të Jashtëm të Emergjencës sipas Nenit 13.
2. Tarifa e referuar në Paragrafin 1 nuk duhet të tejkalojë kostot e arsyeshme që lindin kur njësia e qeverisjes vendore teston Planin e Jashtëm të Emergjencës.
3. Tarifat e referuara në paragrafin 1 përcaktohen nga njësia e qeverisjes vendore në bazë të ligjit për taksat dhe tarifat vendore.

### **Neni 29 Aktet nën-ligjore në zbatim të këtij ligji**

1. Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nën-ligjore në lidhje dhe në përputhje me sa përcaktohet në këtë ligj, brenda 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për nxjerrjen e akteve nën-ligjore në zbatim të Neneve 7.6, 9.14, 9.14, 11.5, 12.13, 15.8, 22.5, 23.4, 24.2, 26.5, 27.3.

### **Neni 30 Amendime dhe shfuqizime**

*Duhet të merret në konsideratë se cili legjislacion tjetër mund të kërkojë amendime ose shfuqizime si rezultat i hyrjes në fuqi të këtij Ligji.*

### **Neni 31 Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

## Aneksi I. Substancat e rrezikshme për të cilat zbatohet ky Ligj

### Hyrje

1. Ky Aneks zbatohet për praninë e substancave të rrezikshme në çdo ndërmarrje dhe përcakton se si zbatohen Nenet përkatëse të këtij Ligji në përputhje me Nenin 4(1).
2. Përzierjet dhe preparatet, nëse nuk jepet specifikisht përqindja e përbërjes apo ndonjë përshkrim tjetër, trajtohen njëjloj si substancat e pastra me kusht që ato të mbeten brenda kufijve të përcaktuar të përqendrimit të përcaktuara në bazë të vetive të tyre sipas dispozitave përkatëse të specifikuara në Pjesën 2, Shënimi 1.
3. Sasitë kualifikuese të përcaktuara në Pjesët 1 dhe 2 janë për çdo ndërmarrje.
4. Sasitë që duhen konsideruar për zbatimin e Neneve përkatëse janë sasitë maksimale që janë të pranishme apo kanë gjasa të jenë të pranishme në çdo kohë. Substancat e rrezikshme të pranishme në një ndërmarrje vetëm në sasi të barabarta me ose më pak se 2 % të sasisë përkatëse të kualifikuar nuk merren parasysh për qëllime të llogaritjes së sasisë totale të pranishme nëse vendndodhja e tyre brenda ndërmarrjes është e tillë që nuk mund të veprojë si shkak fillestar për aksidente madhore diku tjetër në atë territor.
5. Rregullat e dhëna në Pjesën 2, Shënimi 4 mbi mbledhjen e substancave të rrezikshme, apo kategoritë e substancave të rrezikshme, zbatohen atje ku është e përshtatshme.
6. Për qëllime të këtij Ligji, gaz është çdo substancë që ka trysni absolute avulli të barabartë me ose më të madhe se 101,3 kPa në temperaturën 20° C.
7. Për qëllime të këtij Ligji, lëng është çdo substancë që nuk është përkufizuar si gaz dhe që nuk është në gjendje të ngurtë në temperaturën 20°C dhe në trysninë standarte 101,3 kPa.

### Pjesa 1 Substancat e emërtuara

Kur një substancë apo grup substancash të listuara në këtë Pjesë bie në një kategori të Pjesës 2, duhen përdorur sasitë kualifikuese të përcaktuara në këtë Pjesë.

| <b>Kolona 1</b>   | <b>Kolona 2</b>                                 | <b>Kolona 3</b> |
|---|---|-----------------|
| <b>Substancat e rrezikshme</b>  | <b>Sasia (ton) kualifikuese për zbatimin e:</b> |                 |
|   | <b>Neneve 7 dhe 8</b>                           | <b>Nenit 9</b>  |
| Nitrat amoni (1)  | 5 000   | 10 000          |
| Nitrat amoni (2)  | 1 250   | 5 000           |
| Nitrat amoni (3)  | 350   | 2 500           |
| Nitrat amoni (4)  | 10  | 50              |
| Nitrat kaliumi (5)  | 5 000   | 10 000          |
| Nitrat kaliumi (6)  | 1 250   | 5 000           |
| Brom  | 20  | 100             |
| Klor  | 10  | 25              |
| Përbërjet e nikelit në formë pluhuri të thithshme (monoksid nikeli, dioksid nikeli, sulfur nikeli, disulfur trinikeli, trioksid |   | 1               |

| <b>Kolona 1</b>  | <b>Kolona 2</b>                                 | <b>Kolona 3</b> |
|--|---|-----------------|
| <b>Substancat e rrezikshme</b>   | <b>Sasia (ton) kualifikuese për zbatimin e:</b> |                 |
|  | <b>Neneve 7 dhe 8</b>                           | <b>Nenit 9</b>  |
| dinikeli)  |   |                 |
| Etilenemin   | 10  | 20              |
| Fluor  | 10  | 20              |
| Formaldehid (përqendrim $\geq 90\%$ )  | 5   | 50              |
| Hidrogjen  | 5   | 50              |
| Klorur hidrogjeni (gaz i lëngshëm)   | 25  | 250             |
| Alkilet e plumbit  | 5   | 50              |
| Gazrat e lëngshme ekstremisht të djegshme (përfshirë LPG) dhe gazin natyror  | 50  | 200             |
| Acetilen   | 5   | 50              |
| Oksid etileni  | 5   | 50              |
| Oksid propileni  | 5   | 50              |
| Metanol  | 500   | 5 000           |
| 4, 4-Metilen-bis (2-kloranilin) dhe /ose kripëra, në formë pluhuri   |   | 0.01            |
| Metilizocianat   |   | 0.15            |
| Oksigjen   | 200   | 2 000           |
| Diizocianat tolueni  | 10  | 100             |
| Diklorur karbonili (fosgjen)   | 0.3   | 0.75            |
| Trihidrid arseniku (arsin)   | 0.2   | 1               |
| Trihidrid fosfori (fosfin)   | 0.2   | 1               |
| Diklorur sulfuri   | 1   | 1               |
| Trioksid sulfuri   | 15  | 75              |
| Poliklorodibenzofuranet dhe poliklorodibenzodioksonat (përfshirë TCDD), llogaritur në TCDD ekuivalente   |   | 0.001           |
| KARCINOGENET e mëposhtme në përqendrim mbi 5 % sipas peshës:<br>4-Aminobifenili dhe/ose kripërat e tij,<br>Benzotrikloruri, Benzidin dhe/ose kripërat,<br>Bis (klorometil) eteri, Kloro-metil eteri,<br>1,2-Dibromoetani, Sulfat dieteli, Sulfat dimetili, Klorur dimetikarbamili, 1,2-Dibromo-3-kloropropani, 1,2-Dimetilhidrazin, Dimetilnitrozamin, Triamid heksametilfosfori, Hidrazin, 2- Naftilamina dhe / ose kripërat, 4- Nitrodifenil, dhe 1,3 Propansultonit | 0.5   | 2               |
| Produktet e naftës:<br>(a) benzinat dhe naftat (hidrokarbure të tjera të përpunuara, të avulueshme dhe të djegëshme),<br>(b) kerosenet (përfshirë karburantet reaktive),<br>(c) gasoil-ët (përfshirë karburantet diezel, naftat për ngrohjen e shtëpive dhe përzierje të gazoileve)  | 2 500   | 25 000          |

## Shënime

### 1. Nitrat amoni (5 000/10 000): plehëruesit e aftë për tu vetë-dekompozuar

Zbatohet për plehëruesit e përbërë/përbërjet me bazë nitrat amoni (përbërjet/plehëruesit e përbërë që përmbajnë nitrat amoni me fosfat dhe/ose potasë/kripë kaliumi) në të cilët përmbajtja e azotit si rezultat i nitratit të amonit është:

- midis 15.75 %<sup>2</sup> dhe 24.5 %<sup>3</sup> sipas peshës dhe/ ose jo me më shumë se 0.4 % materiale të djegshme/organike totale,
- 15.75 %<sup>4</sup> sipas peshës ose më pak dhe materiale të djegshme të pakufizura,

dhe të cilat janë në gjendje të vetë-dekompozohen sipas Testit të Vasketës të Kombeve të Bashkuara (UN Trough test)<sup>5</sup>.

### 2. Nitrati i amonit (1 250/5 000): grada e plehëruesit

Zbatohet për plehëruesit me bazë direkte nitrat amoni dhe për përbërjet/ plehëruesit e përbërë me bazë nitrat amoni tek të cilët përmbajtja e azotit si rezultat i nitratit të amonit është:

- më shumë se 24.5 % sipas peshës, me përjashtim të përzierjeve të nitratit të amonit me dolomit, gur gëlqeror dhe/ose karbonat kalçiumi me pastërti të paktën prej 90 %,
- më shumë se 15.75 % sipas peshës për përzierjet e nitratit të amonit dhe sulfatit të amonit,
- më shumë se 28 %<sup>6</sup> sipas peshës për përzierjet e nitratit të amonit me dolomite, gur gëlqeror dhe/ose karbonat kalçiumi me pastërti prej të paktën 90 %, dhe që plotëson kërkesat e testit të rezistencës ndaj plasjes së plehërave siç përcaktohet në legjislacione të veçantë për plehërat me nitrat amoni direkt me përmbajtje të lartë azoti<sup>7</sup>.

### 3. Nitrat amoni (350/2500): grada teknike

Zbatohet për:

- nitratin e amonit dhe preparatet prej nitrat amoni ku përmbajtja e azotit si rezultat i nitratit të amonit është:
  - midis 24.5 % dhe 28 % sipas peshës, dhe që nuk përmban më shumë se 0.4 % substanca të djegshme,
  - më shumë se 28 % sipas peshës dhe që nuk përmban më shumë se 0.2 % substanca të djegshme,
- tretësirat ujore të nitratit të amonit ku përqendrimi i nitratit të amonit nuk është më shumë se 80 % sipas peshës.

<sup>2</sup> 15.75% përmbajtje azoti sipas peshës si rezultat i nitratit të amonit korrespondon me 45% nitrat amoni

<sup>3</sup> 24.5% përmbajtje azoti sipas peshës si rezultat i nitratit të amonit korrespondon me 70% nitrat amoni

<sup>4</sup> 15.75% përmbajtje azoti sipas peshës si rezultat i nitratit të amonit korrespondon me 45% nitrat amoni

<sup>5</sup> shih Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për Transportin e Mallrave të Rrezikshme: Manuali i Testimeve dhe Kriteve, Pjesa III, nënseksioni 38.2.

<sup>6</sup> 28% përmbajtje azoti sipas peshës si rezultat i nitratit të amonit korrespondon me 80% nitrat amoni

<sup>7</sup> që transpozojnë Direktivën 80/876/EEC e datës 15 Korrik 1980 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me plehërat me nitrat amoni direkt me përmbajtje të lartë azoti.



**4. Nitrati i amonit (10/50): materialet dhe plehërat “jashtë kontrollit” që nuk përmbushin testin e plasjes**

Zbatohet për:

- materialin e refuzuar (skarco) gjatë procesit të prodhimit dhe nitratin e amonit dhe preparatet prej nitrati amoni, plehërat me bazë nitrati amoni direkt dhe përbërjet/plehërat e përbërë me bazë nitratin e amonit të referuar në Shënime 2 dhe 3, që kthehen ose janë kthyer nga përdoruesi përfundimtar tek një prodhues, magazinimin e përkohshëm apo impiantin e ripërpunimit për ripunimin, riciklimin ose trajtimin për përdorim të sigurt, pasi ato nuk i respektojnë më specifikimet e Shënimeve 2 dhe 3;
- plehërat e referuar në Shënimin 1, kryeradha e parë, dhe Shënimin 2 dhe që nuk plotësojnë kërkesat e testit të rezistencës ndaj plasjes së plehërave siç përcaktohet me legjislacion të veçantë për plehërat me nitrati amoni direkt me përmbajtje të lartë azoti<sup>8</sup>

**5. Nitrati i kaliumit (5 000/10 000):**

Zbatohet për plehërat e përbërë me bazë nitratin e kaliumit në formë granulare.

**6. Nitrati i kaliumit (1 250/5 000):**

Zbatohet për plehërat e përbërë me bazë nitratin e kaliumit të përbërë nga nitrati i kaliumit në formë kristaline.

**7. Poliklorodibenzofuranet dhe poliklorodibenzodioksinat**

Sasitë e poliklorodibenzofuraneve dhe poliklorodibenzodioksinat llogariten duke përdorur faktorët e mëposhtëm:

**Faktorët Ekuivalentë Toksikë Ndërkombëtarë (ITEF) për kongjenerët (elementët, substancat, përbërjet e të njëjtit grup) me interes (NATO/CCMS)**

| Faktorët Ekuivalentë Toksikë Ndërkombëtarë (ITEF) për kongjenerët me interes (NATO/CCMS) |       |                     |       |
|--|-------|---------------------|-------|
| 2,3,7,8-TCDD   | 1     | 2,3,7,8-TCDF        | 0.1   |
| 1,2,3,7,8-PeDD   | 0.5   | 2,3,4,7,8-PeCDF     | 0.5   |
| 1,2,3,4,7,8-HxCDD  | 0.1   | 1,2,3,4,7,8-HxCDF   | 0.1   |
| 1,2,3,6,7,8-HxCDD  |       | 1,2,3,7,8,9-HxCDF   |       |
| 1,2,3,7,8,9-HxCDD  |       | 1,2,3,6,7,8-HxCDF   |       |
|  |       | 2,3,4,6,7,8-HxCDF   |       |
| 1,2,3,4,6,7,8-HpCDD  | 0.01  |                     |       |
| OCDD   | 0.001 | 1,2,3,4,6,7,8-HpCDF | 0.01  |
|  |       | 1,2,3,4,7,8,9-HpCDF |       |
|  |       | OCDF                | 0.001 |

(T = tetra, P = penta, Hx = hekza, HP = hepta, O = okta)

<sup>8</sup> që transpozojnë Direktivën Direktiva 80/876/EEC e datës 15 Korrik 1980 për përafrimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me plehërat me nitrati amoni direkt me përmbajtje të lartë azoti.

## Pjesa 2 Kategoritë e substancave dhe preparateve që nuk janë përmendur specifikisht në Pjesën 1

| Kolona 1   | Kolona 2  | Kolona 3       |
|--|---|----------------|
| <b>Kategoritë e Substancave të rrezikshme</b>  | <b>Sasitë kualifikuese (ton) të substancave të rrezikshme për zbatimin e:</b> |                |
|  | <b>Neneve 7 dhe 8</b>   | <b>Nenit 9</b> |
| 1. SHUMË TOKSIKE   | 5   | 20             |
| 2. TOKSIKE   | 50  | 200            |
| 3. OKSIDUESE   | 50  | 200            |
| 4. SHPËRTHYESE (2)<br>kur substanca, preparati apo artikulli bie në Ndarjen 1.4 të UN/ADR <sup>9</sup> .   | 50  | 200            |
| 5. SHPËRTHYESE (2)<br>kur substanca, preparati apo artikulli bie në ndonjë nga Ndarjet 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 ose 1.6 të UN/ADR apo në frazën e riskut R2 ose R3 | 10  | 50             |
| 6. TË DJEGSHME<br>(kur substanca apo preparati mbulohet nga përkufizimi i dhënë në Shënimin 3 (a))   | 5 000   | 50 000         |
| 7a. SHUMË TË DJEGSHME<br>(kur substanca apo preparati mbulohet nga përkufizimi i dhënë në Shënimin 3 (b) (1))  | 50  | 200            |
| 7b. Lëngjet SHUME TË DJEGSHME<br>(kur substanca apo preparati mbulohet nga përkufizimi i dhënë në Shënimin 3 (b) (2))  | 5 000   | 50 000         |
| 8. EKSTREMISHT TË DJEGSHME<br>(kur substanca apo preparati mbulohet nga përkufizimi i dhënë në Shënimin 3 (c))   | 10  | 50             |
| 9. Frazat e riskut të RREZIKSHME PËR MJEDISIN:   |   |                |
| i) R50: ‘Shumë toksike për organizmat ujore’ (përfshirë R50/53)  | 100   | 200            |
| ii) R51/53: ‘Toksike për organizmat ujore; mund të shkaktojë efekte negative afatgjata në mjedisin ujor’   | 200   | 500            |
| 10. ÇDO KLASIFIKIM që nuk mbulohet nga sa më sipër kombinuar me frazat e riskut:   |   |                |
| (i) R14: ‘hyn në reaksion / ndërvepron fuqishëm me ujin’ (përfshirë R14/15)  | 100   | 500            |
| (ii) R29: ‘në kontakt me ujin, çliron gaz toksik’  | 50  | 200            |

### Shënime

- Për qëllime të këtij Aneksi substancat dhe preparatet do të klasifikohen sipas legjislacionit të posacëm mbi klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të

<sup>9</sup> Marreveshja Evropiane për Transportin Nderkombëtar të Mallrave të Rrezikshëm në rrugë automobilistike, konkluduar më 30 Shtator 1957, e amenduar, në të cilën Republika e Shqipërisë është pale që në 26 Janar 2005.

rrezikshme dhe të preparateve të rrezikshme, pavarësisht nëse ky klasifikim kërkohet ose jo për qëllime të atij legjislacioni.<sup>10</sup>

Për substancat dhe preparatet që nuk janë klasifikuar si të rrezikshme sipas legjislacionit të sipërpërmendur, si për shembull mbetjet, por që megjithatë janë të pranishme ose ka gjasa të jenë të pranishme në një ndërmarrje, dhe që në kushtet e asaj ndërmarrje zotërojnë ose ka gjasa të zotërojnë veti ekuivalente për potencial për aksidente madhore, ndiqen procedurat për klasifikimin e përkoshëm sipas atij legjislacioni.

Për substancat dhe preparatet me veti që i rendisin ato në më shumë se një klasifikim, për qëllime të këtij Ligji zbatohen sasi të më të vogla kualifikuese. Megjithatë për zbatimin e rregullit në Shënimin 4, sasia kualifikuese e përdorur duhet të jetë gjithmonë ajo që korrespondon me klasifikimin në fjalë.

2. “eksploziv” është:

- substanca apo preparati që krijon risk për një shpërthim nëpërmjet goditjes, fërkimit, zjarrit apo burime të tjera ndezjeje (faza e riskut R2),
- substanca apo preparati që krijon risk ekstrem për një shpërthim nëpërmjet goditjes, fërkimit, zjarrit apo burime të tjera ndezjeje (faza e riskut R3), ose
- substanca, preparati apo artikulli i përfshirë në Kategorinë 1 të UN/ADR.

Në këtë përkufizim përfshihen piroteknikat, që për qëllime të këtij Ligji përkufizohen si substanca (apo përzierje substancash) të shpallura për të prodhuar nxehtësi, dritë, zë, gaz apo tym ose kombinim të këtyre efekteve nëpërmjet reaksioneve kimike ekzotermike që shkaktojnë vetë. Kur substanca apo preparati klasifikohet si nën UN/ADR ashtu edhe në frazën e riskut R2 ose R3, do të mbizotërojë klasifikimi UN/ADR gjatë përcaktimit të frazave të riskut.

Substancat dhe artikujt e Kategorisë 1 klasifikohen në një prej ndarjeve nga 1.1 deri në 1.6 në përputhje me skemën e klasifikimit të UN/ADR. Ndarjet përkatëse janë:

*Ndarja 1.1:* “Substancat dhe artikujt që mbartin rrezik për shpërthim masiv (shpërthim masiv është shpërthimi që prek pothuaj të gjithë ngarkesën praktikisht menjëherë).”

*Ndarja 1.2:* “Substancat dhe artikujt që mbartin rrezik për shpërthim të parashikuar por jo rrezik për shpërthim masiv.”

*Ndarja 1.3:* “Substancat dhe artikujt që mbartin rrezik zjarri dhe ose rrezik të vogël plasjeje ose rrezik të vogël të parashikuar ose të dyja, por jo rrezik për shpërthim masiv:

<sup>10</sup> është fjala për legjislacionin vendas që ka tranpozuar apo do të transpozojë:

- Direktivën e Këshillit 67/548/EEC të datës 27 Qershor 1967 për përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme, dhe
- Direktivën 1999/45/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 31 Maj 1999 në lidhje me përafrimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të Shteteve Anëtare në lidhje me klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e preparateve të rrezikshme.

- (a) djegia e të cilave shkakton rritje të konsiderueshme të nxehtësisë rrezatuese; ose
- (b) që digjen njëra pas tjetrës, duke prodhuar plasje të vogla ose efekte të parashikuara, ose të dyja.”

*Ndarja 1.4:* “Substancat dhe artikujt që përfaqësojnë vetëm një risk të vogël në rast ndezjeje ose iniciimi gjatë transportit. Efektet janë të izoluara kryesisht në pako dhe nuk pritet asnjë parashikim i fragmenteve me përmasë apo gamë të dukshme. Një zjarr i jashtëm praktikisht nuk do të shkaktojë shpërthim të menjëhershëm të të gjithë përmbajtjes së pakos.”

*Ndarja 1.5:* “Substancat shumë të pandjeshme që mbartin rrezik për shpërthim masiv janë kaq të pandjeshme sa që, në kushte normale të transportit, probabiliteti për ndezjen apo kalimin nga djegia në plasje është shumë i ulët. Si kërkesë minimale, ato nuk duhet të shpërthejnë në testin e zjarrit të jashtëm”

*Ndarja 1.6:* “Artikujt ekstremisht të pandjeshëm që nuk mbartin rrezik për shpërthim masiv. Artikujt përmbajnë vetëm substanca plasëse ekstremisht të pandjeshme dhe demonstron probabilitet të papërfillshëm për iniciimin apo përhapjen e aksidentit. Risku kufizohet në shpërthimin e një artikulli të vetëm.”

Në këtë përkufizim përfshihen gjithashtu edhe substancat apo preparatet shpërthyes apo piroteknike që përmbahen në artikuj. Për artikujt që përmbajnë substanca apo preparate shpërthyes apo piroteknike, nëse sasia e këtyre substancave apo preparateve është e njohur, për qëllime të këtij Ligji do të konsiderohet ajo sasi. Nëse sasia nuk është e njohur, atëherë, për qëllime të këtij Ligji, i gjithë artikulli do të trajtohet si eksploziv.

- 3. 'I djegshëm', 'shumë i djegshëm', dhe 'ekstremisht i djegshëm' në kategoritë 6, 7 dhe 8 nënkupton:
  - (a) lëngje të djegshme:
    - substancat dhe preparatet që e kanë pikën e ndezjes të barabartë me ose më të madhe se 21°C dhe më të vogël se ose të barabartë me 55°C (faza e riskut R 10), e që mbështesin djegien;
  - (b) lëngje shumë të djegshme:
    - 1. - substancat dhe preparatet që mund të nxehen dhe përfundimisht të marrin flakë në kontakt me ajrin në temperaturën e mjedisit dhe pa ndonjë input energjie (faza e riskut R 17),
    - substancat dhe preparatet që e kanë pikën e ndezjes në temperaturë më të ulët se 55°C dhe që nën trysni mbeten në gjendje të lëngët, që në kushte të veçanta prapëpunimi, siç janë trysnia e lartë ose temperatura e lartë, mund të shkaktojnë rreziqe për aksidente madhore;
    - 2. substancat dhe preparatet që e kanë pikën e ndezjes në temperaturë më të ulët se 21°C dhe që nuk janë ekstremisht të djegshme (faza e riskut R 11, kryeradha e dytë);
  - (c) gazrat dhe lëngjet ekstremisht të djegshme:
    - 1. substancat dhe preparatet e lëngshme që e kanë pikën e ndezjes në

- temperaturë më të ulët se 0°C dhe se pika e vlimit (ose pika fillestare e vlimit kur ka disa të tilla) e cila nën tryzni normale është më e vogël ose e barabartë me 35°C (faza e riskut R 12, kryeradha e parë), dhe
2. gazrat që janë të djegshëm në kontakt me ajrin në temperaturën dhe tryzsinë e mjedisit (faza e riskut R12, kryeradha e dytë), që gjenden në gjendje të gaztë ose superkritike, dhe
  3. substancat dhe preparatet e lëngshme të djegshme dhe shumë të djegshme që mbahen në temperaturë më të lartë se pika e tyre e vlimit.

4. Në rast se në një ndërmarrje substancat apo preparatet nuk janë të pranishme në sasi më të mëdha apo të barabarta me sasi të përkatëse kualifikuese, për të përcaktuar nëse ndërmarrja mbulohet nga kërkesat përkatëse të këtij Ligji zbatohet rregulli i mëposhtëm: Ky Ligj zbatohet nëse shuma

$q1/Q_{U1} + q2/Q_{U2} + q3/Q_{U3} + q4/Q_{U4} + q5/Q_{U5} + \dots$  është më e madhe ose e barabartë me 1,

ku  $q_x$  = sasia e substancës së rrezikshme x (ose kategoria e substancave të rrezikshme) që bie në Pjesët 1 ose 2 të këtij Aneksi,  
dhe  $Q_{UX}$  = sasia kualifikuese përkatëse për substancën apo kategorinë x nga kolona 3 e Pjesëve 1 ose 2.

Me përjashtim të Neneve 9, 11 dhe 15 ky Ligj zbatohet nëse shuma

$q1/Q_{L1} + q2/Q_{L2} + q3/Q_{L3} + q4/Q_{L4} + q5/Q_{L5} + \dots$  është më e madhe ose e barabartë me 1,

ku  $q_x$  = sasia e substancës së rrezikshme x (ose kategoria e substancave të rrezikshme) që bie në Pjesët 1 ose 2 të këtij Aneksi,  
dhe  $Q_{LX}$  = sasia kualifikuese përkatëse për substancën apo kategorinë x nga kolona 2 e Pjesëve 1 ose 2.

Ky rregull përdoret për të vlerësuar rreziqet e përgjithshme që lidhen me toksicitetin, djegshmërinë dhe eko-toksicitetin. Për këtë arsye, duhet zbatuar tre herë:

- (a) për shtimin e substancave dhe preparateve të emërtuara në Pjesën 1 dhe të klasifikuara si toksike ose shumë toksike, së bashku me substancat dhe preparatet që bien në kategoritë 1 ose 2;
- (b) për shtimin e substancave dhe preparateve të emërtuara në Pjesën 1 dhe të klasifikuara si oksiduese, shpërthyes, të djegshme, shumë të djegshme ose ekstremisht të djegshme, së bashku me substancat dhe preparatet që bien në kategoritë 3, 4, 5, 6, 7a, 7b ose 8;
- (c) për shtimin e substancave dhe preparateve të emërtuara në Pjesën 1 dhe të klasifikuara si të rrezikshme për mjedisin (R50 (përfshirë R50/53) ose R51/53), së bashku me substancat dhe preparatet që bien në kategoritë 9(i) ose 9(ii);

Dispozitat përkatëse të këtij Ligji zbatohen nëse ndonjëra nga shumatat e përfuara nga (a), (b) ose (c) është më e madhe ose e barabartë me 1.

## **Aneksi II. Parimet që duhet të mbahen parasysh gjatë përgatitjes së planeve për parandalimin e aksidenteve madhore**

Me qëllim zbatimin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore dhe sistemit të menaxhimit të sigurisë së operatorit, duhet të mbahen parasysh elementët e mëposhtëm. Kërkesat e parashtruara në dokumentin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore duhet të jenë në proporcion me rreziqet e pranishme për aksidentet madhore në ndërmarrje.

1. Politika e parandalimit të aksidenteve madhore hartohet me shkrim dhe përmban qëllimet dhe parimet e përgjithshme të operatorit për të vepruar në lidhje me kontrollin e rreziqeve për aksidente madhore.
2. Sistemi i menaxhimit të sigurisë përmban pjesë të sistemit të përgjithshëm të menaxhimit që përfshin strukturën organizative, përgjegjësitë, praktikat, proçedurat, proçeset dhe burimet për përcaktimin dhe zbatimin e politikës së parandalimit të aksidenteve madhore.
3. Sistemi i menaxhimit të sigurisë duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:
  - (a) organizimi dhe personeli — rolet dhe përgjegjësitë e personelit të përfshirë në menaxhimin e rreziqeve madhore në të gjitha nivelet e organizimit. Identifikimi i nevojave për trajnimin e këtij personeli dhe ofrimi i trajnimit të identifikuar. Përfshirja e nënpunësve dhe personelit të nënkontraktuar që punon në ndërmarrje;
  - (b) identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve madhore – miratimi dhe zbatimi i proçedurave për identifikimin sistematik të rreziqeve madhore që lindin nga operimi normal dhe jonormal dhe vlerësimi i probabilitetit dhe rëndësisë së tyre;
  - (c) kontrolli operacional – miratimi dhe zbatimi i proçedurave dhe udhëzimeve për operim të sigurt, përfshirë mirëmbajtjen e impiantit, proçeseve, paisjeve dhe ndalesave të përkohshme;
  - (d) menaxhimi i ndryshimeve – miratimi dhe zbatimi i proçedurave për planifikimin e modifikimeve ose të projekteve të reja të instalimeve, proçeseve ose faciliteteve të magazinimit;
  - (e) planifikimi për rastet e emergjencave — miratimi dhe zbatimi i proçedurave për identifikimin e emergjencave të parashikueshme nëpërmjet analizave sistematike, për përgatitjen, testimin dhe shqyrtimin e planeve të emergjencave për të reaguar ndaj tyre dhe për të ofruar trajnime specifike për stafin në fjalë. Trajnime të tilla i duhen ofruar të gjithë personelit që punon në ndërmarrje, përfshirë personelin e nënkontraktuar;
  - (f) monitorimi i performancës - miratimi dhe zbatimi i proçedurave për vlerësimin e vazhdueshëm të përmbushjes së objektivave të vendosura nga politika e parandalimit të aksidenteve madhore dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë së operatorit, dhe mekanizmat për investigimin dhe marrjen e masave korrektuese në rast mos-përmbushje. Proçedurat duhet të mbulojnë sistemin e operatorit për raportimin e aksidenteve madhore të near misses, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me mosrealizimin e masave mbrojtëse, investigimin e tyre dhe vazhdimësinë në bazë të mësimave të nxjerra;

- (g) auditimi dhe shqyrtimi - miratimi dhe zbatimi i procedurave për vlerësimin periodik sistematik të politikës së parandalimit të aksidenteve madhore dhe efektshmërisë dhe përshtatshmërisë së sistemit të menaxhimit të sigurisë; shqyrtimi i dokumentuar i performancës së politikës dhe sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe përditësimi i tij nga menaxhimi i lartë.

## **Aneksi III. Përmbajtja e Raportit për Sigurinë**

### **Pjesa 1 – Qëllimi i raporteve për sigurinë**

Qëllimet e raporteve për sigurinë të referuara në Nenin 9 janë:

1. Të demonstronjë që politika e parandalimit të aksidenteve madhore dhe sistemi i menaxhimit të sigurisë për zbatimin e saj janë vënë në zbatim në përputhje me informacionin e përcaktuar në Aneksin II.
2. Të demonstronjë që rreziqet nga aksidentet madhore janë identifikuar dhe që masat e nevojshme janë marrë për të parandaluar aksidente të tilla dhe për të kufizuar pasojat e tyre tek njerëzit dhe mjedisi.
3. Të demonstronjë që siguria dhe besueshmëria e duhur janë inkorporuar në:
  - (a) Projektimin dhe ndërtimin, dhe
  - (b) operimin dhe mirëmbajtjene çdo instalimi, fasiliteti magazinues, paisje dhe infrastrukture të lidhur me operimin e tij që kanë të bëjnë me rreziqe nga aksidente madhore brenda ndërmarrjes.
4. Të demonstronjë që janë hartuar planet e brendshme të emergjencës dhe që këto ofrojnë informacion që mundëson hartimin e planeve të jashtme me qëllim që të ndërmerren masat e nevojshme në rast aksidenti madhor.
5. Të ofrojnë informacion të mjaftueshëm për autoritetet përkatëse për të mundësuar marrjen e vendimeve për përcaktimin e vendit për aktivitetet apo zhvillimet e reja përreth ndërmarrjes.

### **Pjesa 2 – Informacioni minimal që duhet përfshirë në raportin për sigurinë**

1. Emri dhe adresa e organizatave që janë angazhuar për përgatitjen dhe hartimin e raportit për sigurinë.
2. Informacion për sistemin e menaxhimit dhe organizimit të ndërmarrjes me qëllim parandalimit të aksidenteve madhore.  
Ky informacion duhet të përmbajë elementet e përcaktuar në Aneksin II.
3. Prezantimi i mjedisit të ndërmarrjes:
  - (a) përshkrimi i territorit dhe mjedisit të tij, përfshirë vendodhjen gjeografike, kushtet meteorologjike, gjeologjike, hidrografike dhe, nëse është e nevojshme, historinë e tij;
  - (b) identifikimi i instalimeve dhe aktiviteteve të tjera të ndërmarrjes që mund të shfaqin rreziqe për aksidente madhore;
  - (c) përshkrimi i zonave ku mund të ndodhë një aksident madhor.
4. Përshkrimi i instalimit:
  - (a) përshkrimi i aktiviteteve dhe produkteve kryesore të pjesëve të ndërmarrjes që janë të rëndësishme nga pikëpamja e sigurisë, burimet e riskut për aksidente madhore dhe kushtet në të cilat mund të ndodhin aksidente të tilla madhore, së bashku me përshkrimin e masave parandaluese të propozuara;



- (b) përshkrimi i proceseve, në veçanti i metodave operative;
  - (c) përshkrimi i substancave të rrezikshme –
    - (i) inventari i substancave të rrezikshme, i përditësuar sipas nevojës, përfshirë:
      - 1. identifikimin e cdo substance të rrezikshme: emrin kimik, numrin CAS<sup>11</sup>, emrin sipas nomenklaturës IUPAC<sup>12</sup>,
      - 2. sasinë maksimale të substancave të rrezikshme të pranishme ose që kanë gjasa të jenë të pranishme;
    - (ii) karakteristikat fizike, kimike, toksikologjike dhe treguesin e rreziqeve, si të menjëhershme ashtu edhe të vonuar, për njerëzit dhe mjedisin;
    - (iii) sjelljen fizike dhe kimike në kushtet normale të përdorimit ose sipas kushteve aksidentale të parashikuara.
5. Identifikimi dhe analiza e risqeve aksidentale dhe metodat e parandalimit të tyre:
- (a) përshkrim i detajuar skenarëve për aksidentet madhore të mundshme dhe probabiliteti ose kushtet në të cilat ato ndodhin, përfshirë një përmbledhje të ngjarjeve që mund të luajnë rol në shkaktimin e këtyre skenarëve, shkaqeve të brendshme apo të jashtme të instalimit;
  - (b) vlerësim i shkallës dhe seriozitetit të pasojave të aksidenteve madhore të identifikuar përfshirë hartat, imazhet ose, sipas rastit, përshkrimet ekuivalente, që tregojnë zonat që janë të predispozura për t'u prekur nga aksidente të tilla që rezultojnë nga ndërmarrja, që është subjekt i dispozitave të konfidencialitetit të përcaktuar me legjislacion të veçantë;
  - (c) përshkrim i parametrave teknikë dhe paisjeve të përdorura për sigurinë e instalimeve.
6. Masat mbrojtëse dhe të ndërhyrjes për të kufizuar pasojat e aksidentit:
- (a) përshkrimi i paisjeve të instaluara në impiant për të kufizuar pasojat e aksidenteve të mëdha;
  - (b) organizimi i alarmit dhe ndërhyrjes;
  - (c) përshkrimi i burimeve mobilizuese, të brendshme ose të jashtme;
  - (d) përmbledhja e elementeve të përshkruar në germet (a), (b), dhe (c) të këtij paragrafi të nevojshme për të hartuar planin e brendshëm të emergjencës.

### **Pjesa 3. Kriteret që duhen përdorur për kufizimin e informacionit që duhet përfshirë në raportin për sigurinë**

#### ***Hyrje***

1. Dispozita e Nenit 9(11) të këtij Ligji synon të shmangë kërkesat e panevojshme administrative për një ndërmarrje, nqse substanca të veçanta të pranishme atje nuk

<sup>11</sup> është një numër i përcaktuar për cdo substancë kimike nga Shërbimi Kimik Abstrakt (CAS) si identifikues unik i asaj substance.

<sup>12</sup> Nomenklatura e kimikateve IUPAC, më e pëdorura në të gjithë botën është zhvilluar dhe përditësuar nga Unioni Ndërkombëtar i Kimisë së Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC).

- janë të afta të shkaktojnë rrezik për aksidente madhore. Autoriteti Kompetent merr një vendim të tillë për çdo ndërmarrje rast pas rasti. Megjithatë, është e qartë që çdo leje/përjashtim i bërë sipas këtij paragrafi lidhet vetëm me kufizimin e informacionit të kërkuar në Raportin për Sigurinë dhe nuk e çliron operatorin nga detyrimet e tjera të këtij Ligji. Ndërmarrja vazhdon të jetë ndërmarrje e nivelit më të lartë.
2. Operatorit të ndërmarrjes së nivelit më të lartë i kërkohet nga Neni 9 i këtij Ligji të dorëzojë Raportin për Sigurinë, i cili duhet të përmbajë një inventar të përditësuar të substancave të rrezikshme të pranishme në ndërmarrje.
  3. Me fjalë të tjera, të gjitha substancat e pranishme në ndërmarrje që janë 'substancat të rrezikshme' sipas përkufizimit të Nenit 2 të këtij Ligji, duhet të konsiderohen edhe në rast se sasi të nuk i plotësojnë nivelet e pragut të përcaktuara në Aneksin I.
  4. Për pasojë një leje/përjashtim sipas Nenit 9(11) të këtij Ligji mund të lidhet me çdo substancë të rrezikshme të pranishme në një ndërmarrje, pavarësisht nga sasi të kualifikuese të këtij Ligji. Duhet theksuar se një substancë e pranishme në një pjesë të ndërmarrjes, të themi në një instalim të veçantë, mund të kualifikohet për leje/përjashtim kur e njëjta substancë diku tjetër në ndërmarrje mund të mos kualifikohet.

### ***Kriteret***

Leja/përjashtimi sipas Nenit 9(11) të këtij Ligji mund të jepet nga Autoriteti Kompetent nëse përmbushet të paktën një nga kriteret e përgjithshme të mëposhtme.

#### **1. Forma fizike e substancës**

Substancat në formë të ngurtë, nga të cilat (si në kushte normale ashtu edhe në çfarëdo kushtesh jo-normale që mund të parashikohen llogjikisht) nuk mund të ndodhë asnjë çlirim lënde apo energjie, që mund të shkaktojë rrezik për aksident madhor,

#### **2. Përmbajtja dhe sasi të**

Substancat e ambalazhuara ose të mbyllura/ izoluara në mënyrë dhe në sasi të tilla që çlirimi maksimal i mundshëm në çfarëdo rrethanash nuk mund të shkaktojë rrezik për aksidente madhore.

#### **3. Vendndodhja dhe sasi të**

Substancat e pranishme në sasi dhe në distanca të tilla nga substancat e rrezikshme (në ndërmarrje apo diku tjetër) që as mund të shkaktojnë vetë rrezik për aksidente madhore dhe as nuk mund të iniciojnë aksidente madhore që përfshin substanca të tjera të rrezikshme.

#### **4. Klasifikimi**

Substancat që janë perkufizuar si substanca të rrezikshme në sajë të klasifikimit të përgjithshëm në Aneksin I, Pjesa 2 e këtij Ligji, por që nuk mund të shkaktojnë rrezik për aksident madhor, dhe për të cilat klasifikimi i përgjithshëm është i papërshtatshëm për këtë qëllim.

## **Aneksi IV. Përmbajtja e Planeve të Emergjencës**

### **Pjesa 1 Objektivat e planeve të emergjencës**

Planet e emergjencës të përmendura në Kreun 4 duhet të hartohen në përputhje me objektivat e:

1. përmbajtjes dhe kontrollit të incidenteve me qëllim që të minimizojnë efektet dhe të kufizojnë dëmet mbi njerëzit, mjedisin dhe pronën;
2. zbatimit të masave të nevojshme për mbrojtjen e njeriut dhe mjedisit nga efektet e aksidenteve madhore;
3. komunikimit të informacionit të nevojshëm për publikun dhe shërbimet apo autoritetet e zonës ku ndodhet ndërmarrja;
4. sigurimit të rehabilitimit dhe pastrimit të mjedisit pas aksidenteve madhore;
5. marrjes në konsideratë të nevojës për të lehtësuar rritjen e bashkëpunimit në ndihmën e mbrojtjes civile në emergjencë madhore, për sa i përket planeve të jashtme të emergjencës.

### **Pjesa 2 Informacioni që duhet përfshirë në planin e brendshëm të emergjencës**

1. Emrat ose pozicionet e personave të autorizuar për fillimin e procedurave të emergjencës dhe të personit përgjegjës për koordinimin e veprimeve lehtësuese në territorin e ndërmarrjes.
2. Emri ose pozicioni i personit përgjegjës për lidhjen me autoritetin përgjegjës për planin e jashtëm të emergjencës.
3. Për kushte apo ngjarje të parashikueshme që mund të jenë të rëndësishme për shkaktimin e një aksidenti madhor, përshkrimin e veprimit që duhet të ndërmerret për të kontrolluar kushtet apo ngjarjet dhe për të kufizuar pasojat e tyre, përfshirë përshkrimin e paisjeve të sigurisë dhe burimet e disponueshme.
4. Masat/përgatitjet për kufizimin e risqeve tek personat në territorin e ndërmarrjes përfshirë mënyrën se si duhen dhënë paralajmërimet dhe veprimet që priten të ndërmerren nga njerëzit me marrjen e paralajmërimit.
5. Masat/përgatitjet për të siguruar që autoriteti përgjegjës për fillimin e planit të jashtëm të emergjencës është paralajmëruar hershëm për incidentin, lloji i informacionit që duhet të përmbahet në një paralajmërim fillestar dhe masat/përgatitjet për sigurimin e informacionit më të hollësishëm ndërsa ai bëhet i disponueshëm.
6. Masat/përgatitjet për trajnimin e stafit për detyrat që priten të kryejnë, dhe kur është e nevojshme koordinimi me shërbimet e jashtme të emergjencës.
7. Masat/përgatitjet për ofrimin e ndihmës me veprimet lehtësuese jashtë territorit të ndërmarrjes.

### **Pjesa 3**

#### **Informacioni që duhet përfshirë në raportin e jashtëm për sigurinë**

1. Emrat ose pozicionet e personave të autorizuar për fillimin e procedurave të emergjencës dhe personat e autorizuar për të drejtuar dhe koordinuar veprimet jashtë territorit të ndërmarrjes.
2. Masat/përgatitjet për marrjen e paralajmërimeve të hershme për incidentet dhe procedurat e alarmit dhe të njoftimeve.
3. Masat/përgatitjet për koordinimin e burimeve të nevojshme për të zbatuar planin e jashtëm të emergjencës.
4. Masat/përgatitjet për ofrimin e ndihmës me veprime lehtësuese në territorin e ndërmarrjes.
5. Masat/përgatitjet për veprime lehtësuese jashtë territorit të ndërmarrjes.
6. Masat/përgatitjet për t'i dhënë publikut informacion specifik lidhur me aksidentin dhe mënyrën se si ai duhet të veprojë në këtë rast.
7. Masat/përgatitjet për t'i dhënë informacion shërbimeve të emergjencës të Shteteve të tjera në rast aksidenti madhor me pasoja të mundshme ndërkufitare.

## **Aneksi V. Informacioni që i duhet dhënë publikut**

Informacioni që i duhet dhënë publikut në mbështetje të Nenit 15(1) është:

- 1.** Emri i operatorit dhe adresa e ndërmarrjes.
- 2.** Identifikimi, sipas pozicionit që mban, i personit që jep informacionin.
- 3.** Konfirmimi që ndërmarrja është subjekt i këtij Ligji dhe që njoftimi i referuar në Nenin 7, apo raporti për sigurinë i referuar në Nenin 9 është dorëzuar tek Autoriteti Kompetent.
- 4.** Shpjegim me terma të thjeshtë për aktivitetin apo aktivitetet e ndërmarra në ndërmarrje.
- 5.** Emrat e përbashkët ose, në rastin e substancave të rrezikshme të trajtuara nga Pjesa 2 e Aneksit I, emrat e përgjithshëm ose klasifikimin e përgjithshëm të rrezikut të substancave dhe preparateve që përdoren në ndërmarrje që mund të shkaktojnë aksident madhor, me një tregues të karakteristikave të tyre kryesore të rrezikshme.
- 6.** Informacion i përgjithshëm në lidhje me natyrën e rreziqeve nga aksidentet madhore, përfshirë efektet e tyre potenciale mbi popullsinë dhe mjedisin.
- 7.** Informacion i mjaftueshëm për mënyrën se si popullsia përkatëse do të paralajmërohet dhe mbahet e informuar në rastin e një aksidenti madhor.
- 8.** Informacion i mjaftueshëm për veprimet që popullsia përkatëse do të ndërmarrë, dhe për mënyrën se si duhet të veprojnë në rast aksidenti madhor.
- 9.** Konfirmim që operatori duhet të marrë masat e nevojshme në territorin e tij, në veçanti të lidhet me shërbimet e emergjencës, për t'u marrë me aksidentet dhe për të pakësuar efektet e tyre.
- 10.** Referencë për planin e jashtëm të emergjencës të hartuar me të gjitha efektet jashtë territorit nga aksidenti. Kjo duhet të përfshijë këshilla për të bashkëpunuar me cilindo udhëzim apo kërkesë nga shërbimet e emergjencës në kohën kur ndodh aksidenti.
- 11.** Hollësitë se ku mund të përftohet informacion i mëtejshëm përkatës, subjekt i kërkesave të konfidencialitetit të parashtruara me legjislacion të veçantë.

## **Aneksi VI. Raportimi për aksidentet madhore**

Operatori i ndërmarrjes është i detyruar të raportojë çdo aksident që trajtohet nga paragrafi 1 ose që mbart të paktën një nga pasojat e përshkruara në paragrafët 2, 3, 4 dhe 5:

### **1. Substancat e përfshira**

Çdo zjarr, shpërthim apo shkarkim aksidental të substancave të rrezikshme që përmban një sasi prej të paktën 5 % të sasisë kualifikuese të përcaktuar në kolonën 3 të Pjesëve 1 ose 2 të Aneksit I.

### **2. Plagosjen e personave dhe dëmtimet e pronave të paluajtshme**

- Një aksident që përfshin drejtpërsëdrejti një substancë të rrezikshme dhe shkakton një nga ngjarjet e mëposhtme:
  - o një vdekje,
  - o gjashtë persona të plagosur brenda ndërmarrjes dhe të shtruar në spital të paktën për 24 orë,
  - o një person jashtë ndërmarrjes të shtruar në spital të paktën për 24 orë,
  - o banesa(t) jashtë ndërmarrjes, të dëmtuara dhe të bëra të papërdorshme si rezultat i aksidentit,
  - o evakuim ose izolim të njerëzve për më shumë se 2 orë (persona × orë): vlera është të paktën 500,
  - o ndërprerje të shërbimeve të ujit të pijshëm, energjisë elektrike, gazit dhe telefonisë për më shumë se 2 orë (persona × orë): vlera është të paktën 1 000.

### **3. Dëmet e menjëhershme në mjedis**

- dëme të përhershme apo afatgjata në habitatet tokësore:
  - o 0,5 ha ose më shumë e një habitati me rëndësi për mjedisin apo për tu ruajtur që mbrohet me ligj,
  - o 10 ose më shumë hektarë të një habitati me përhapje të gjerë, përfshirë tokën bujqësore,
- dëme të konsiderueshme apo afatgjata në habitatet me ujëra të ëmbla dhe detare:
  - o 10 km ose më shumë e një lumi a kanali,
  - o 1 ha ose më shumë e një liqeni a pellgu,
  - o 2 ha ose më shumë e një delte,
  - o 2 ha ose më shumë e vijës bregdetare apo detit të hapur,
- dëme të konsiderueshme në shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësore
  - o 1 ha ose më shumë.

### **4. Dëmet mbi pronën**

- dëme në pronat e ndërmarrjes: të paktën 2 milionë Euro,
- dëme në pronat jashtë ndërmarrjes: të paktën 0,5 milionë Euro.

## **5. Dëmet ndër-kufitare**

Çdo aksident që përfshin drejtpërsëdrejti një substancë të rrezikshme që shkakton efekte jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Operatori i ndërmarrjes është i detyruar të raportojë edhe cdo aksident apo “aksident të shmatur në castin e fundit” që nuk përmbush kriteret sasiore të mësipërme, por që Autoriteti Kompetent apo Autoriteti i Inspektimit i konsiderojnë me interes të veçantë teknik për parandalimin e aksidenteve madhore dhe kufizimin e pasojave të tyre.